

AKT THEMELIMI

|
SHOQËRISË

“FarmVita” SH.P.K

Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, me Ortak të Vetëm

Sot, me datë 18.05.2025 (dymijë e njëzet e pese), në Tiranë, pranë selisë së shoqërisë “FarmVita” sh.p.k, me pjesëmarrjen e ortakut të vetëm z.Ardit BENJA, (*më poshtë njojur si “Ortaku”*) nënshkruhet ky Akt Themelimi, si vijon:

z.Ardit BENJA, shtetas shqiptar, lindur në Kuçove, me datë 12-08-1990 (njëmijë e nentëqind e tetëdhjetë), mbajtës i letërnjoftimit (ID) Nr.Personal J00812003C dhe banues Kuçove, njojur këtu e mëposhtë si ortaku i vetëm i shoqërisë me pjesmarrje në përqindje 100% (njëqind përqind), të kapitalit të shoqërisë “FarmVita” sh.p.k.

I. Themelimi

Ortaku i vetëm deklaron në unanimitet të plotë, themelimin e shoqërisë “FarmVita” sh.p.k, si një shoqëri tregtare shqiptare me përgjegjësi të kufizuar (“**Shoqëria**”).

1. Selia administrative e Shoqerisë është në adresën: **Rruga Ali Benja, ndertesa e pare, Perondi, Kuçove, Berat**.

Shoqëria është themeluar përafat 20 (njëzet) vjeçar, i cili mund të përterihet me Vendim të Ortakut/Ortakëve.

II. Objekti

Në përputhje me statutin dhe licensat e përfituar nga institucionet përgjegjëse, shoqëria do të kryej veprimtarite, si me poshtë: Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë: mbjellja e perimeve, rritja dhe tregtimi i tyre, përpunimi dhe konservimi i produkteve bujqësore e blegtorale, si dhe çdo veprimtari tjeter e lidhur me bujqësinë dhe zhvillimin rural.

III. Statuti

Ortaku i Vetëm z.Ardit BENJA, deklaron pajisjen e Shoqerisë me Statutin e Shoqerisë.

IV. Kapitali

Kapitali themeltar i shoqerisë është 100 (njëqind) lekë, i përbërë nga 1 Kuotë e Përgjithëshme. Kuota e shoqërisë zotërohet nga ortaku i vetëm i shoqërisë me numër të pjesëve 1,00 dhe pjesëmarrje në përqindje 100 % (njëqind përqind).

I gjithë kapitali i shoqerisë zotërohet nga Ortaku i Vetëm z.Ardit Benja, me vlerë kapitali në para 100 (njëqind) lekë, me numër të pjesëve 1,00 dhe pjesëmarrje në përqindje 100 % (njëqind përqind). Çdo kuotë i jep të drejtën e një votë zoteruesit të tij.

Kapitali i Shoqerisë është nënshkruar dhe shlyer tërësisht nga Ortaku.

V. Administratori

Shoqëria do të drejtohet nga 1 (një) Administrator. Administratori do të jetë përgjegjës për administrimin e përditshëm të Shoqerisë "FarmVita" sh.p.k, sipas kufizimeve të vendosura nga Statutët dhe legjislacionet e Republikës së Shqipërisë.

Administrator i Shoqerisë "FarmVita" sh.p.k, emërohet:

z.Ardit BENJA, shtetas shqiptar, lindur në Kucove , me datë 12-08-1990, mbajtës i letërnjoftimit (ID) me Nr.Personal J00812003C dhe banues Tiranë në Kucove;

- Administratori emerohet nga Ortaku në cilesinë e anëtarit të vetëm të Asamblesë se Përgjithshme të Shoqerisë, i cilët ka të drejtë dhe kompetencë të plotë ta shkarkojë me vendim të zakonshëm Administratorin, për çdo arsy.
- Administratori emerohet për një afat 5 (pesë) vjeçar dhe mund te ri-emerohet me vendim asambleje të përgjithshme të ortakut/ ortakeve të shoqerisë.
- Kompetencat dhe detyrat e Administratorit, mund te ndryshohen me vendim asambleje të përgjithshëm të ortakut/ëve të shoqerisë.

Shoqëria "FarmVita" sh.p.k, do të përfaqesohet ndaj të tretëve nëpërmjet nënshkrimit të vetëm të Administratorit të tij, të vendosur nën vulën e Shoqërisë, nëse nuk parashikohet ndryshtësia në Statutin e Shoqërisë dhe/ose në një vendim të ardhshëm të ortakut/ëve të shoqerisë.

ORTAKU I VETËM

z.Ardit BENJA

A handwritten signature in black ink, appearing to read "ARDIT BENJA" followed by a stylized surname. The signature is fluid and cursive, with the initials "AB" at the beginning and a more decorative end.